

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN KOTË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Kotë, Vlorë**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 100, datë 31.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 366/8, datë 31.07.2015, i ka rekomanduar z. Ferdinand Aligjoni, Kryetar i bashkisë Selenicë ku përfshihet njësia administrative Kotë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Për periudhën objekt auditimi është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk ka funksionuar. Nuk është hartuar plani strategjik i menaxhimit financiar, ku të përfshihej misioni, vizioni, objektivat, plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Në këtë njësi vendore stafi drejtues, nuk ka njohje të ligjit dhe koncepteve të tij si dhe të komponentëve të MFK. Nga menaxheri i njësisë vendore nuk ishin marrë masa trajnuese për njohjen e këtij ligji dhe vënien në zbatim të tij. Në këto kushte në mbyllje të aktivitetit të Komunës, hartimi i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK, janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për njohjen nga e ligjit të MFK dhe komponentëve të tij, ngritjen e një sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat, që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen objektivat, prioritetet me afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Në fund të periudhës ushtrimore të bëhet vetëvlerësimi dhe të raportohet për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Vazhdimisht

2. Gjetje: Mungojnë programe të plota financiare afatmesme (PBA) në kundërshtim me UMF nr. 20/1, datë 26.02.2011, nr. 7/1, datë 29.02.2012 dhe nr.9/1 datë 25.02.2013 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”. Programet buxhetore vjetore janë paraqitur për miratim në Këshillin e komunës thjesht, duke përshkruar të dhënat tabelore, pa një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë, me një planifikim të pastudiuar dhe të fryrë pa bazë reale të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke e kthyer buxhetin e vitit koherent në buxhet inkohorent, që pjesën e më të madhe financon borxhet e trashëguara të viteve të mëparshme. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të buxhetit të paraqitura pranë Këshillit të Komunës si dhe analiza faktoriale e treguesve të realizimit të ardhurave dhe shpenzimeve UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit të zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe atij vjetor të mirëstudiuar, hartimin dhe planifikimin e treguesve, të bazuar mbi hartimin më parë të planit strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Vazhdimisht

3. Gjetje: Është hartuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komunës Kotë, por nuk është miratuar me vendim të Këshillit të Komunës në kundërshtim me ligjin nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 32 pika

(ç). Rregullorja nuk kishte të përcaktuar misionin e kësaj njësi vendore, përgjegjësitë dhe detyrat e stafit të administratës. Për të gjithë sektorët janë përcaktuar misionet, dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave ndërtohet funksioni i këtyre strukturave dhe elementet e kodit etik e konfliktit të interesit, por nuk janë përcaktuar detyrat individuale për çdo punonjës sipas strukturës nga niveli më i lartë deri te niveli i ulët. Kësaj rregulloreje i mungon përcaktimi i formës dhe mënyrë së komunikimit si asaj verbale ashtu dhe asaj shkresore dhe metoda e llogaridhënies .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, duke e plotësuar me të gjithë elementët e domosdoshëm si ndarjen përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiive për çdo punonjës, sipas strukturës nga niveli më i lartë deri te niveli i ulët, vendosjen e linjave të raportimit që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin e detyrave, formën e komunikimit dhe metodat e llogaridhënies.

Menjëherë

4. Gjetje: Në pagesat për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël në 13 raste në vlerën 2,235,211 lekë për vitin 2012, në 14 raste në vlerën 2,241,273 lekë për vitin 2013 dhe në 5 raste në vlerën 1,264,585 lekë në vitin 2014 ,u paraqitën mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: kërkesat për përcaktimin e nevojave për blerje, argumentimi i fondit limit, mungesë të dokumentit të raportit kualifikimit final të miratuar nga Kryetari i AK, njoftimi i fituesit dhe aktit të marrjes në dorëzim punimeve etj. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, Udhëzimin e APP nr.2, datë 28.03.2013 “për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me UMFnr.33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 37, rubrika “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara” pika 42,43 dhe 44.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e dokumenteve financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga titullari.

Vazhdimisht

5. Gjetje: Për të tre vitet mungon regjistri i parashikimit dhe i realizimit të dërguar në APP për prokurimet me vlerë të vogël në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut I të pikës 2/a Kreu i VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ” të ndryshuar dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.28, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 1 dhe 4.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për hartimin e regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të blerjeve me procedurën prokurimit të blerjeve me vlera të vogla dhe të depozitohet pranë APP.

Vazhdimisht

6. Gjetje: Për veprimet me arkën është mbajtur vetëm libri i arkës dhe nuk është mbajtur ditar arke në formën klasike të kontabël, por në formën e një regjistri të mbajtur nga Zyra e Tatim-Taksave, duke mos i klasifikuar sipas llogarive përkatëse të klasës 7 si dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare është bërë nga jashtë dhe jo sipas standarteve kontabël. Gjithashtu vjelja e të ardhurave nga ujësjellësi, është kryer nga faturistët në terren pa prerë mandat-arkëtimet në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”pika 61,62 dhe 67 .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për kontabilizimin e të ardhurave që nga azhurnimi i të ardhurave në librin ditar, prerjen e artikujve kontabël për llogaritë që preken deri në paraqitjen e gjendjeve në llogaritë e klasës 7 të të ardhurave në pasqyrat financiare. Po kështu të merren masa, që për abonentët e ujit të priten dokumentet financiare si fatura e mandat-arkëtimi.

7. Gjetje: Nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri, kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 **"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"**, kap III, pika 30.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë), konkretisht Zyra e Financës të marrë masa, të krijojë dhe të mbahet regjistri i aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimit, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit.

Deri me datë 31.12.2015

8. Gjetje: Në mbylljen e ditarëve artikujt kontabël, nuk janë hedhur në sistemin centralizator, apo në librin e madh, në të cilën duhet të ishin pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara, sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarët në fund të periudhës ushtrimore, procedurë kjo në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, që gjatë kontabilizimit dhe hartimit të bilancit të ndiqen hapat e duhura kontabël, për veprimet ekonomike të ndodhura, që nga azhurnimi në ditar, kuadrimi i shumave në mënyrë periodike dhe në fund të periudhës ushtrimore, prerja e artikujve kontabël, mbartja e shumave në sistemin centralizator ose në librin mastro, nxjerrja e gjendjeve të llogarive përkatëse të prekura nga veprimet ekonomike, hartimin e bilancit vërtetues deri në hartimin e bilancit përfundimtar.

Vazhdimisht

9. Gjetje: Në lidhje me kryerjen e procesit të inventarizimit rezultoi se për vitin 2012 nuk është kryer procesi i inventarizimit për aktivet nën administrim të Komunës, ndërsa për vitet 2013 dhe 2014 komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi nuk ka hartuar procesverbalet për argumentimin teknik të gjendjes jashtë funksionit të inventarit ekonomik, inventari i imët në shkollë dhe Komunë. Gjithashtu mungon dokumentacioni për kryerjen e hapave të mëtejshme për tjetërsimin apo asgjësimin e tyre, pasi nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi nuk është hartuar asnjë procesverbal për përshkrimin e destinacionit të fundit të këtyre aktiveve. Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël, duke bërë pakësimet në llogaritë përkatëse pa i dhënë zgjidhje përfundimtare këtyre aktiveve. Kjo e procedurë e ndjekur është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve", pika 109.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, duke proceduar sipas kërkesave ligjore për inventarët të nxjerra jashtë përdorimi, duke kryer procesin e tjetërsimit apo të asgjësimit të shoqëruara me veprimet kontabël përkatëse.

Menjëherë

10. Gjetje: Nuk janë miratuar me vendim të Këshillit të Komunës pronat, të cilat me VKM nr. 311, datë 18.03.2009, kanë kaluar në pronësi të Komunës Kotë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 9, 10, 13 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar me VKM nr. 1277, datë 23.12.2009 dhe nenin 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Rekomandim: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Selenicë (ku përfshihet Komuna Kotë), ku ZMMT të paraqesë në Këshillin e Bashkisë dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor në zbatim të kërkesave të nenit 32, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 për miratimin e

pronave që me VKM nr. 311, datë 18.03.2009 dhe me VKM nr.588, datë 14.05.2008 i kanë kaluar në pronësi të Komunës Kotë.

Deri me datë 31.12.2015

11. Gjetje: Marrja në dorëzim e fondit pyjor dhe kullor nga DRSHP, sipas VKM nr.588, datë 14.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Kotë, të Qarkut Vlorë” me procesverbalin e datës 28.07.2008 nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes pyjore në terren për verifikimin e përcaktimeve të procesverbalit, si dhe nuk janë kryer përcaktimet përfundimtare me njësitë vendore kufitare për territorin e shtrirjes së këtij fondi dhe saktësimin në hartat shoqëruese të kufijve nën administrimin e komunës Kotë, duke mos zbatuar kërkesat e VKM nr. 804, datë 4.6.2008, mbi “Dorëzimin e fondit pyjor dhe kullor”, nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenet 9, 10, 13 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe neni 30, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/ 26, neni 11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap III, pika 30 .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa dhe të kryejë inventarizimin fizik dhe përgatitjen e dokumentacionit ligjor mbi gjendjen e statusit juridik të 5834.1 ha sipërfaqe pyjeve dhe kullota, të cilat me VKM nr. 588, datë 14.05.2008 janë transferuar në pronësi të Komunës.

Deri me datë 31.12.2015

12. Gjetje: Komuna Kotë nuk ka kryer procedurat e nevojshme ligjore për regjistrimin në ZRPP Vlorë, të pronave që me VKM nr.588, datë 14.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Kotë, të Qarkut Vlorë dhe VKM nr. 311, datë 18.03.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore në Komunën Kotë, të Qarkut Vlorë”, kanë kaluar në pronësi të saj. Në këtë rast, mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenet 7, 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, neni 6 i ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar dhe nenet 24, 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm tekniko ligjor, për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave kanë kaluar në pronësi të saj.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje: Komuna ka dhënë me qira të 2753 ha të fondit kullor në përdorim, në bazë fshati dhe shfrytëzimit të përbashkët, për disa familje dhe kapacitetit për krerë sipas kategorisë, duke zbatuar tarifat e miratuara me VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”. Kështu për periudhën 2012-2013 janë lidhur dhe arkëtuar 77 kontrata me vlerë qiraje 589,700 lekë ;për periudhën 2013-2014 janë lidhur dhe arkëtuar 67 kontrata me vlerë 478,000 lekë dhe për periudhën 2014-2015 janë lidhur dhe arkëtuar 58 kontrata me vlerë 449,500 lekë. Në të gjitha procedurat e kontraktimit e dhënies me qira, paraqiten parregullsi në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 4 datë 10.4.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien për kullotje e kositje bari”pika 2,3,4,5,15 me Urdhrin e nr. 450 datë 17.12.2008 të Ministrisë së Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për miratimin e manualit “rregullat dhe kërkesat teknike të trajtimit, përdorimit e shfrytëzimit të pyllit komunal”.,me ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë”nenet 420 dhe 693 .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa që për rastet e dhënies me qira të fondit kullor pronë e ish-komunës, të sigurojë që të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës së dhënies me qira dispozitat ligjore që nga miratimi, publikimi i listës së ngastrave të kullotave, administrimi dhe plotësimi i dokumentacionit të kërkuar për përdorim të kullotave, shqyrtimi i kërkesave deri në lidhjen e monitorimin e kontratave me vlefshmëri ligjore, me përdoruesit e kullotave, të cilët nuk kanë detyrime ndaj Komunës.

Vazhdimisht

14. Gjetje: Nga Komuna Kotë për vitin bujqësor 01.09.2012-31.08.2013, janë dhënë me qira 61.2 ha tokë e lirë, me 26 kontrata të lidhura dhe arkëtuar në vlerën 367,200 lekë, për vitin bujqësor 01.09.2013-31.08.2014, janë dhënë me qira 58.8 ha tokë e lirë me 30 kontrata të lidhura dhe të arkëtuara në vlerën 352,800 lekë dhe për vitin bujqësor 01.09.2014-31.08.2015, janë dhënë me qira 70.7 ha tokë e lirë me 34 kontrata me vlerë 424,200 lekë. Në të gjitha procedurat dhe kontraktimin e dhënies me qira, u konstatuan parregullsi në kundërshtim me UKM Nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 234, datë 9.7.2007 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore”.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, që për dhënie me qira të tokave të pandara pronë e ish-komunës në përdorim fermerëve, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore në miratimin e listës së ngastrave, publikimin, pranimin e kërkesave të plotësuara sipas kërkesave ligjore, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për qiradhënien nga (KQTBP), i cili duhet të jetë i plotë dhe të funksionojë konform dispozitave ligjore, si dhe kontratat e lidhura, të rivlerësohen dhe të përfshijnë të gjithë elementët e kontratave tip të përcaktuara në dispozitat ligjore të sipërpërmendura, duke i dhënë forcë ligjore për penalizim palëve në rastet e moszbatimit të kushteve të saj.

Vazhdimisht

15. Gjetje : Komuna Kotë ka proceduar dhe miratuar dhënie me qira në 6 raste për objekte, të cilat kanë qenë në përdorim, të cilat janë kontraktuar për shumë vite edhe para vitit 2012. Vlera e qiradhënies është bërë në bazë të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” me çmimin dyshe me prej 50 lekë/m² dhe sipërfaqeve përkatëse. Aktmarrëveshjet e lidhura midis palëve, në të 6 rastet, nuk janë sipas formularit të kontratës tip të qiradhënies të objekteve pronë shtet, në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, pasi nuk kanë të përfshirë të drejtat dhe detyrimet e palëve nëpërmjet dispozitave të veçanta, të përgjithshme dhe të përbashkëta si dhe sanksionet. Këto aktmarrëveshje nuk janë të shoqëruara me aktin e pronësisë, planimetrinë dhe me procesverbalin e dorëzimit të objektit në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” kapitulli VI “Monitorimi i kontratave” pika 2/a.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, që dhënia me qira e objekteve pronë e ish-komunës në të 6 rastet, të rivlerësohen dhe të rikualifikohen juridikisht në zbatim të akteve ligjore në fuqi, duke rillogaritur vlerën e qiras dhe kërkuar arkëtimin e diferencave që do të rezultojnë. Njëkohësisht të hartohen kontrata sipas kërkesave të Kodit Civil me të gjithë elementet, duke i dhënë vlefshmëri dhe forcë ligjore mbi bazën e të cilave të sigurohen respektimi dhe zbatimi i detyrimeve të palëve dhe në rast të kundërt penalizimi i tyre.

Vazhdimisht

16. Gjetje: Është proceduar për dhënie me qira të fondit prej të 70.7 ha të tokave të pandara në 34 raste në vlerën 424,200 lekë për vitin bujqësor 01.09.2014-31.08.2015 në kundërshtim me Udhëzimin të KM nr. 3, datë 27.11.2013 “Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr. 1, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për të bërë të pavlefshme kontratat dhe ndalimin e përdorimit të ngastrave të fondit të tokave të pandara pronë e ish-kooperativave bujqësore për vitin bujqësor 01.09.2015-31.08.2016, veprime këto që janë kryer në zbatim të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 27.11.2013 “Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr. 1, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” deri në një periudhë të dytë me daljen e një akti administrativ për zhbllokimin dhe lejimin e procedimit të dhënies me qira të tokave të lira.

Menjëherë

17. Gjetje: Është lejuar zaptimi dhe përdorimi i paligjshëm i pasurive në pronësi të kësaj Komune, prona të llojit truall, ngrehina dhe objekte të ish-zyrave të Komunes, objekte të shërbimit social dhe të kulturës pa pasur marrëdhënie ligjore (pronësie a qiraje), që ka sjellë si pasojë përfitime të paligjshme, ku mos kontraktimi dhe mos vjelja e qirave për shfrytëzimin e këtyre objekteve, kanë sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Komunes .
Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për mos lejimin dhe mosvazhdimin e përdorimit të paligjshëm dhe shfrytëzimin e pasurive truall në pronësi të ish-Komunes, prona të ish-Kooperativës Bujqësore dhe ish ndërmarrjeve, truallit për ndërtime shtëpi e përdorime ngrehinash kryesisht nga banorët, zaptim i truallit për kultivime bujqësore, pa pasur marrëdhënie ligjore (*pronësie a qiraje*) lidhur me truallin, duke i vënë ato në efikasitet për sigurim të ardhurash, si dhe të krijohet korrespondencë me ALUIZNI-n, për saktësimin e pronave që janë në proces legalizimi.

Menjëherë e në vijimësi

18. Gjetje: Në të gjithë tenderët, Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka siguruar ndarjen e detyrave për nëpunësit e përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit, në kundërshtim me kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu V, pika 1/a, 2/a dhe ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, nenet 15, 22 .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa që nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë), të sigurohet ndarja e detyrave për të gjithë nëpunësit e përfshirë, në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të vlerësimit gjatë fazës së zhvillimit të prokurimeve.

Vazhdimisht

19. Gjetje: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka kryer kontrolle në subjektet taksa pages mbi lëshimin ose jo të kuponëve tatimore, mbi mbajtjen e librave të xhiros etj., veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë), konkretisht Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara sipas kërkesave të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007, në bashkëpunim me Policinë e Komunes.

Vazhdimisht

20. Gjetje: Në Komunën Kotë, për vitet 2012,2013 dhe 2014, kanë ushtruar aktivitetin e tyre 118 subjekte të biznesit të vogël, të pa regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), të cilat nuk kanë paguar taksat lokale në shumën **4,486,929 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e nenet 40, 41 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masat e nevojshme ligjore me qëllim, regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të kërkojë arkëtimin e shumës **4,486,929 lekë** nga 118 subjektet e pa regjistruara.

Menjëherë

21. Gjetje: Për vitet 2012-2013 dhe 2014 dhe 4-mujorin e parë të vitit 2015 vlera e debitorëve e llogaritur sipas fshatrave, për taksën e tokës është 3,955,211 lekë. Të ardhurat e taksës së ndërtesës vitet 2012,2013 dhe 2014 nuk janë arkëtuar, duke krijuar mungesë të ardhurash në vlerën 1,148,500 lekë. Gjithashtu nga periudha para viteve 2012 për taksën e tokës dhe banesës së bashku, është trashëguar një vlerë debitoare prej 20,193,445 lekë dhe debia e akumuluar deri me datë 31.03.2015 në vlerën 25,297,156 lekë .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë), konkretisht Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë dhe të ndjekin hapat ligjorë e administrativ, për arkëtimin nga debitorët të vlerës 25,297,156 lekë, si detyrim i pa paguar për taksat dhe tarifatat nga banorët e ish-komunes Kotë.

Deri me datë 31.12.2015

22. Gjetje: Zyra e Taksave Vendore në ish-komunën Kotë nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për 12 subjektet e licencuara të Biznesit të Madh, që nuk kanë paguar detyrimet tatimore deri me datën 31.12.2014, duke sjellë mungesë të ardhurash në shumën 11,205,775 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nenet 89, 90 dhe 91, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 5, shkronja “ç”, nënpika “iii”.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë), konkretisht Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë dhe të ndjekin hapat ligjorë e administrativ, për arkëtimin nga subjektet taksa pagues, të detyrimeve debitorë për vlerën 11,205,775 lekë.

Deri me datë 31.10.2015

23. Gjetje: Në lidhje me prodhimin dhe shitjen e ujit, nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr.236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë” të ndryshuar, pika 4, të UKM nr. 3, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm” kreu II pika 2, 3,6 si për vjeljen e të ardhurave nga tarifa e ujit të pijshëm, ku për gjithë periudhën objekt auditimi nuk janë lidhur kontrata me konsumatorët e ujit, si dhe për arkëtimet në vitet 2013 dhe 2014 janë kryer me lista emërore. Nga komuna për rastet e pagesave me vonesë të tarifës së ujit nga konsumatorët, nuk është aplikuar asnjë gjobë dhe për rastet e mos pagesave, nuk është bërë ndërprerja e ujit.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa në bashkëpunim me SHA Ujsjellës Selenicë, që për realizimin e të ardhurave nga tarifa e ujit, të lidhen kontratat tip të miratuara me konsumatorët familjarë dhe jo familjarë të ish-komunës Kotë, arkëtimi i tarifës të bëhet në bazë të dokumenteve financiare dhe në rastet e pagesës me vonesë apo të mos pagesës së këtij detyrimi, të aplikohen penalitete deri në shpërbimin e ujit të sanksionuara këto në kontrata.

Menjëherë

24. Gjetje: Në lidhje me dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike të tenderave me objekt “Punime të ndryshme në komunën Kotë 2014” dhe objekt “Rikonstruksion i Urës Vodice dhe punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë”, rezultuan mungesa si: plan-organizimi i punimeve të ndërtimit; grafiku i realizimit të punimeve; akt-piketimet për objektet; libri i kantierit; pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip; provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura si hekur, beton etj.; dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse në kundërshtim me nenet 7,12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Kreun I, pika 1 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa që në projektet e investimeve për punime ndërtimi të kërkojë nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve, të kontraktuar për kryerjen e shërbimeve të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve, plotësimin ligjor të dosjes teknike për çdo rast të pagesës dhe kryerjes së këtij shërbimi për realizimin e investimeve.

Vazhdimisht

25. Gjetje: Në pasqyrat financiare, gjendjet e llogarive 230 “Aktivet e Qëndrueshme të trupëzuara”, 210-211 “Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione” n 212 “Ndërtime e konstruksione” 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, nuk janë të analizuar dhe për to nuk ka informacion se çfarë përfaqësojnë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, që në bashkëpunim me Zyrën e Financës të bëjë vlerësimin dhe analizën e vlerave të paraqitura në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Po kështu të kryhet analiza e llogarisë së aktiveve të trupëzuara, ku vlerat analitike e projekt-studimeve të shpërndahen dhe të përfshihen në vlerat e aktiveve të trupëzuara përkatëse.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim **për shpërblimin e dëmit me vlerën 9,977,760 lekë** në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje: Nga auditimi i i regjistrit të ardhurave nga qiratë rezultoi se nga Komuna janë dhënë me qira ngastra nga fondi i tokave të pandara edhe për periudhën përpara vitit 2012, duke filluar që nga viti 2009. Nga përpunimi i të dhënave u konstatua se 21 nga përdoruesit e këtyre ngastrave janë debitorë në shumën 422,400 lekë ndaj Komunës, e akumuluar për periudhën para vitit 2012 deri në datën 31.03.2015, si pasojë e mos pagesës së detyrimit kontraktor për vlerën vjetore të qirasë. Mos pagesa dhe mos derdhja në arkën e Komunës të shumës **422,400 lekë** është në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693, me pikën V/2 të Udhëzimit KM nr.1 datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” ku përcaktohet se: “2. *Pavarësisht se cili është autoriteti qiradhënës, pagesa nga ana e subjekteve qiramarrëse e qirasë së tokave bujqësore të pandara, sipas këtij udhëzimi, bëhet për llogari të komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën, objekt i qirasë*”

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera e **në shumën 422,400 lekë** nga 21 përdoruesit të ngastrave të marra me qira nga fondi i tokave të pandara .

Deri me datë 31.12.2015

2. Gjetje: Sipas regjistrit të ardhurave rezultojnë 7 qiramarrës debitorë me detyrime të pashlyera kontraktore në shumën **850,200 lekë**, ku në 6 raste janë kontrata në vazhdim dhe 1 rast është debitor që në vitin 2007. Mos pagesa dhe mos derdhja në arkën e Komunës të shumës 850,400 lekë është në kundërshtim me pikën 2 dhe 3 të kontratës dhe me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693 .

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera në **shumën 850,200 lekë** nga 7 qiramarrësit e objekteve pronë të Komunës, për aktivitet tregtar dhe banim .

Deri me datë 31.12.2015

3. Gjetje: Sipas regjistrit të ardhurave nga qiratë, rezultoi se 119 nga përdoruesit e ngastrave nga fondi kullor pronë e ish-Komunës Kotë të marrë me qira për kullotje për periudhën përpara vitit 2012, duke filluar që nga viti 2009 e akumuluar deri në datën 31.03.2015 janë debitorë në shumën 1,254,700 lekë. Mos pagesa dhe mos derdhja në arkën e Komunës e detyrimit kontraktor për vlerën vjetore të qirasë në shumën **1,254,700 lekë**, është në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420,693, me Udhëzimin nr. 4 datë 10.4.2008 të Ministrit pika 14, *si dhe me* udhëzim nr. 4, datë 22.4.2013 të Ministrisë “ Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 21.

Rekomandim Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera e në shumën **1,254,700 lekë** nga **119 përdoruesit** të parcelave të marra me qira nga fondi kullor pronë ish-Komunës .

Deri me datë 31.12.2015

4. Gjetje: Për vitet 2012, 2013 dhe 2014, kanë ushtruar aktivitetin e tyre 67 subjekte, të cilat janë pajisur nga ish-Komuna Kotë me certifikatë transporti për nevojat e veta, por që nuk janë regjistruar në QKR. Këto subjekte, nuk kanë paguar detyrimet për taksën e biznesit të vogël, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime dhe nenit 30 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në

transportin rrugorë” me ndryshime, **duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën 1,825,700 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masat e nevojshme ligjore për regjistrimin në QKR të subjekteve, që janë çertifikuar dhe ushtrojnë aktivitetet transport mallrash për nevojat e veta, si dhe të kërkojë arkëtimin e detyrimit tatimor në shumën **1,825,700 lekë nga 67 subjektet**.

Deri me datë 31.12.2015

5. Gjetje: Komuna Kotë nuk ka lidhur kontrata për furnizimin me ujë të abonentëve dhe deri më datën 31.12.2014, rezultoi se nuk është arkëtuar tarifa e ujit të pijshëm nga **412 familje në vlerën 4,733,000 lekë, duke i shkaktuar dëm ekonomik shtetit**, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Komunës nr. 50 datë 14.12.2012 “Për miratimin e tarifës së ujit të pijshëm”, kontratën tip “Për furnizimin me ujë të pijshëm” dhe nenit 850 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa dhe të ndjekë hapat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës debitoare në shumën **4,733,000 lekë** nga 412 konsumatorët e ujit të pijshëm (*sipas tabelës në faqen 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Deri me datë 31.12.2015

6. Gjetje: Në zbatimin e punimeve me objekt “Punime të ndryshme në Komunën Kotë 2014”, u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik “B-93”shpk, **duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 535,560 lekë** në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa administrative e ligjore, për arkëtimin e **vlerës 535,560 lekë**, përfituar tepër nga subjekti “B-93”shpk, për punime të pa kryera në tenderin me objekt “Punime të ndryshme në Komunën Kotë 2014”.

Deri me datë 30.10.2015

7. Gjetje: Në zbatimin e punimeve me objekt “Rikonstruksion i Urës Vodicë dhe punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë ” u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik “S....”shpk, **duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 356,200 lekë**, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Selenicë (në të cilën është përfshirë komuna Kotë) të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **356,200 lekë**, përfituar tepër nga subjekti “S.....” *sh.p.k* për punime të pa kryera në tenderin me objekt objekt “Rikonstruksion i Urës Vodicë dhe punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë ”.

Deri me datë 30.10.2015

C.MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Selenicë (ku është përfshirë ish komuna Kotë), fillimin e procedurave administrative për dhënien e masës disiplinore, nga “**Vërejtje**” deri “**Ndërrprerje të marrëdhënie të punës**”, sipas shkallës së përgjegjësisë, për këta persona:

-Z. P.A me detyrë Përgjegjës i ZMMT-së, në cilësinë e anëtarit të bordit (BQTBP), i cili në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.02.2011”Mënyra e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki” Kreu IV-Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, shkurt (ZMMT) në Komuna dhe Bashki, pika 2, shkronja c:

- Për mos ndjekjen e kontratave të qirave të tokave të pandara , ku si pasojë nuk është arkëtuar shuma prej 422,400 lekë detyrime kontraktore ndaj Komunës të 21 përdoruesve e këtyre ngastrave në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420,693, me pikën V/2 të Udhëzimit KM nr.1 datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”

- Për mos ndjekjen e kontratave të qirave për kullotje të parcelave nga fondi kullësor, ku si pasojë nuk është arkëtuar shuma prej 1,254,700 lekë nga 119 përdoruesit e këtyre ngastrave në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420, 693, me pikën 14 dhe 21 të Udhëzimit nr. 4 datë 10.4.2008 të Ministrit të Bujqësisë .

- Për procedimin në dhënien me qira të tokave të pandara dhe ngastrat për kullotje në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar neni 8 dhe të pikës 4 të vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara"i ndryshuar pika 4, ligjin Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”dhe Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 234, datë 9.7.2007 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore".

Z. I.B me detyrë Përgjegjës i Shërbimeve dhe i Ujësjellësit, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të blerjeve me vlera të vogla:

-Për mos vjeljen e detyrimeve kontraktore për furnizimin me ujë të pijshëm në vlerën në kundërshtim me vendimet e Këshillit të Komunës për paketën fiskale të sipërcituara, me VKM nr.236, datë 10.5.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë” të ndryshuar , pika 4, me UKM nr.3 datë 28.07 2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”pika 2,3 kreu II pika 6.

- Për mos hartimin dhe mos administrimin e kërkesave për përcaktimin nevojave për blerjet me vlera të vogla, dhe në rastet e punimeve të shoqëruara këto me preventivat përkatës si dhe mos hartimin e dokumentacionit teknik për punën e kryer me punëtorët e mjetet e Komunës deri në dorëzimin e tyre në Sektorin e Financës, për mangësitë dhe parregullsitë në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së prcedurave të blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, Udhëzimet e APP “për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”pika 37,42,43 e 44, me UMF nr.33 datë 11.07.2013 e UMF nr.57 datë 12.6.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3.

Z.Q.Sh me detyrë Kryetare e Degës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e kryetares së KPVV për periudhen (01.01.2012-30.04.2013):

Zj.F.L me detyrë Kryetare e Degës së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e kryetares së KPVV për periudhen (01.05.2013-30.06.2015):

- Për mangësitë dhe parregullsitë në plotësimin e dokumentave pjesë të dosjes së prcedurave të blerjeve me vlera të vogla në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pikës 2/a Kreu i VI, Udhëzimet e APP “për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”pika 37,42,43 e 44, me UMF nr.33 datë 11.07.2013 e UMF nr.57 datë 12.6.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3.

- Për mos mbajtjen e rregullt të kontabilitetit, për mos krijimin e regjistrit të aktiveve, për mos ndjekjen e llogjikës kontabël në nxjerrjen e bilancit kontabël (në mungesë të librit të madh apo sistemit centralizator), analizën e gjendjeve Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuar dhe të Trupëzuara të paraqitura në bilanc të trashëguara nga vitet e mëparshëm dhe kryerjen e sistemeve të nevojshme deri në rakordimin me inventarët fizik në kundërshtim me ligjin nr. 9228,datë 29.04.2004“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”i ndryshuar

- Për mangësitë në procedurat e inventarizimit, nxjerrjen jashtë përdorimi deri në asgjësimin e aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli IV “Sistemi i kontrolli periodik të aktiveve”, pika 109.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar dhe nenin 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar i kemi rekomanduar Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Selenicë, Vlorë që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për mbikëqyrësit dhe kolaudatorët si më poshtë:

1. Zj.N.M në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit

- Për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt "Punime të ndryshme në Komunën Kotë 2014" u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik "B.....shpk, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 535,560 lekë si dhe për mungesat e dokumentacionit në dosjen teknike si: plan-organizimi i punimeve të ndërtimit; grafiku i realizimit të punimeve; akt-piketimet për objektet; libri i kantierit; pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip; provat dhe çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura si hekur, beton etj.; dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse në kundërshtim me nenet 7,12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, me Kreun I, pika 1 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 pika 4, paragrafi 4.

2. Z.S.Sh në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit

- Për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt "Punime të ndryshme në Komunën Kotë 2014" u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik "B....."shpk, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 535,560 lekë.

3. Zj. E.V në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit

- Për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt "Rikonstruksion i Urës Vodicë dhe punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë" u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik "S...."shpk, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 356,200 lekë si dhe për mungesat e dokumentacionit në dosjen teknike si: plan-organizimi i punimeve të ndërtimit; grafiku i realizimit të punimeve; akt-piketimet për objektet; libri i kantierit; pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip; provat dhe çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura si hekur, beton etj.; dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse në kundërshtim me nenet 7,12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, me Kreun I, pika 1 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 pika 4, paragrafi 4.

4. Z. T.N në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt "Rikonstruksion i Urës Vodicë dhe punime të ndryshme në rrugët e Komunës Kotë" u konstatuan diferenca në realizimin e punimeve në zëra dhe volume nga operatori ekonomik "S...."shpk, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 356,200 lekë.

Nga Bashkia Selenicë, me shkresë nr.64 prot., datë 24.08.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri Irma Shkupi, Pal Daçi, dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj

Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT